



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1417

NR. VENDIMI 7535

VENDIM  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e përbërë prej

**GJYQTARE: Enkela (Bajo) Vlora**

asistuar nga sekretare gjyqesore Arta Brahja, sot më **date 18.09.2017** mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me **Nr.1417 akti** që i përket:

**PADITES:** Shoqeria \*\*\*, me seli ne \*\*\*, perfaqesuar nga \*\*\*, dhe ne gjykim me procure te pergjithshme dt. \*\*\* nga av. \*\*\*, me licence nr. \*\*\* dhe Nipt \*\*\*.

**E PADITUR:** Shoqeria “\*\*\*, me seli ne \*\*\*, perfaqesur me autorizimin e dt. \*\*\* av. \*\*\* me licence nr. \*\*\* dhe me autorizimin date \*\*\* nga \*\*\*.

**PERSON I TRETË:** Ministria e Kultures (Drejtoria e te Drejtes se Autorit dhe te Drejtave te tjera lidhur me te), me adrese rruga Aleksander Moisiu, nr. 76, ish Kinostudio, perfaqesuar me autorizimin e dates 10.04.2017 nr. \*\*\* nga \*\*\* dhe /ose \*\*\*.

**OBJEKTI:** -Njohjen e shkeljes se te drejtave te autorit nepermjet perdorimit te paautorizuar te programeve kompjuterike pa licensa perkatese nga pala e paditur.  
-Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i paautorizuar i programeve kompjuterike pa licencat përkatëse shkaktuar në vlerën \*\*\* Usd e konvertuar në lekë \*\*\* lekë.  
-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

**BAZA LIGJORE:** Neni 43 I K.Pr.Civile, e ne vijim: Kodi Vivil neni 638,639 e ne vijim; Ligji nr.9380 date 28.04.2005 “Per te drejten e drejtave te tjera te lidhura me te” neni 12,13,75,81 e ne vijim: Marreveshja e TRIPS-it; Konventa e Bernes.

Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e fundit të perfaqesueses

se pales paditese,që kërkoj pranimin e kërkesëpadisë;pretendimet e fundit te perfaqesuesit te pales se paditur qe kerkoi rrezimin e kerkesepadise,pretendimet e fundit te personit te trete dhe e shqyrtoi çështjen teresi(avokatura e shtetit ka relatuar mospjesemarrjen ne gjykim)

## V Ë R E N:

se përpara kësaj gjykate është paraqitur për gjykim çështja civile me objektin e siperpermendur,I rregulluar ne mbeshtetje te nenit 185 te KPrC:

*1. Njohjen e shkeljes së të drejtave të autorit nëpërmjet përdorimit të paautorizuar të programeve kompjuterike, pa licencat përkatëse nga pala e paditur. 2.Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i paautorizuar i programeve kompjuterike pa licencat përkatëse shkaktuar në vlerën \*\*\* Usd e konvertuar në lekë \*\*\* lekë 3.Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.*

Nga provat e paraqitura rezulton se pala paditëse shoqëria \*\*\* është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Uashingtonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e ushtron veprimtarinë e saj prej datës \*\*\*, si një shoqëri e njohur globalisht në fushën e krijimit dhe tregtimit të pajisjeve dhe programeve kompjuterike,nderkohe qe pala e paditur eshte nje subjekt i te drejtes tregetare shqiptare e rregjistruar ne daten 02.10.2013 konform ligjit ne fuqi,me objekt te veprimtarise se saj ne administrimin e call center,etj(sipas percaktime konkrete ne ekstratin e leshuar nga QKR).

Po ashtu nga provat e paraqitura rezulton se ne datë 06/10/2014 Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit(ZSHDA) ka kryer kontroll prane palës së paditur ku ka konstatuar se kjo e fundit shfrytëzonte,perdorte në ambientin e saj tregetar programe kompjuterike të pa licensuara. Pas këtij verifikimi, autoriteti përkatës ka proceduar me gjobitjen e subjektit sipas nenit 131 te ligjit te ndryshuar ‘Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’ sipas gjobës nr. \*\*\*, datë \*\*\*.

Pas këtij fakti te konstatuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka ardhur ne dijeni pala paditese për këtë shkelje dhe me shkresën date \*\*\* ka kërkuar nga pala e paditur arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me të drejtat pasurore që rrjedhin nga e drejta e pronësisë mbi veprën perkundrejt shkeljes se te drejtave te autorit,te shoqerise pale paditese me ane te perdorimit te programeve kompjuterike te palicencuara (pa licencen perkatese)/sa I perket shperblimit te demit te shkaktuar vlera e demit te kerkuar nga pala paditese eshte ne masen \*\*\* Usd.

Ne mungese te nje marreveshje mes paleve pala paditese I eshte drejtuar gjykates se rrethit gjyqesor Tirane me padi ku ka parashtruar pretendimet,faktet dhe provat e saj dhe kerkuar perfundimisht sipas objektit te padise/vlera e shperblimiti te demit kerkuar fillimisht(referuar padise) ishte ne masen \*\*\* Usd dhe ne vijim,gjate gjykimit, ne masen \*\*\* *Usd e konvertuar në lekë \*\*\* leke.*

**Ne shpjegimet/pretendimet e pales paditese gjejme te parashtruara qe** shoqëria \*\*\* është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Uashingtonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e ushtron veprimtarinë e saj prej datës \*\*\*, si një shoqëri e njohur globalisht në fushën e krijimit dhe tregtimit të pajisjeve dhe programeve kompjuterike.Pala paditëse është mbajtës i së drejtës ( pronare ) i disa programeve kompjuterike dhe gëzon të gjitha të drejtat e autorit si dhe të drejtat e markës në përputhje me nenit 75 e vijues të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”;personi i tretë në proces Drejtoria e të Drejtës së Autorit datën 06.10.2014 gjatë inspektimit të kryer nga ish Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit si institucion qëndror, person juridik publik, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është konstatuar se subjekti i paditur shfrytëzonte në ambientin e

tij tregtar, programe kompjuterike të pa pajisura me liçencat përkatëse pra në shkelje të të drejtës së autorit, duke cënuar të drejtën e autorit të palës paditëse. Personi i tretë pas kryerjes së këtij verifikimi duke konstatuar që pala e paditur përdorte paautorizim programin kompjuterike \*\*\* për qëllim tregtimi i cili sot është konvertuar në programin equivalent \*\*\*, inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit kanë proceduar me gjobitjen e subjektit sipas nenit 131, pika të ligji "Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to", fakt ky që vërtetohet nga Fletë-Gjoha Nr. \*\*\* datë \*\*\*. Fakt i cili u provua në gjykim si dhe u pranua nga pala e paditur. Pala paditëse i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit për të na informuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale për klientin tonë. Në këto kushte në datën 03.11.2015, me Nr. \*\*\* Prot. jemi vënë në dijeni nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit për faktet e mësipërme, me anë të shkresës datë 01.12.2015 Nr. \*\*\* Prot, bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Pala paditëse pas marrjes dijeni të inspektimeve të kryera i është drejtuar me anë të një shkrese palës së paditur, në datën 26 Nëntor 2015 si dhe duke i vënë në dukje se përdorimi i programeve kompjuterike të shoqërisë \*\*\* pa liçencat përkatëse sjell si pasojë shkeljen e nenit 12 e vijues të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të". Autori dhe në këtë rast \*\*\* është dhe duhet të ishte përfitues i ligjshëm i të drejtave të tyre të autorit, të cilat pala e paditur i ka pa asnjë të drejtë apo liçencë dhe ka përfituar të drejta pasurore nga programet kompjuterike të \*\*\*; në kushtet kur nga pala e paditur nuk ka pasur asnjë përgjigje, pavarësisht dijenise rezulton se i padituri ka marrë dijeni, i janë drejtuar gjykates për të garantuar të drejtat e njohura nga ligji në lidhje me shkeljen e të drejtës së autorit nëpërmjet përdorimit në qarkullim tregtar të programeve kompjuterike në pronësi të Korporatës \*\*\*.

Pala paditëse ka kërkuar së pari njohjen e shkeljes së drejtës së autorit duke bere referim ne ligjin nr. 9380, datë 8.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të"-nenet 4 dhe 75 e vijues, duke i njohur autorit të drejtën e krijimit të veprës ardhur si pasojë e punës intelektuale duke i njohur për pasojë dhe të drejtën e shfrytëzimit të saj në përputhje me nenet 12 dhe 13 të ligjit

Programet kompjuterike janë një krijim i intelektit njerëzor, autorësia dhe të drejtat mbi to mbrohen jo vetëm nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të" në nenet 75 e në vijim ashtu por ka një rregjim ndërkombëtarë marrëveshjet dhe konventash në të cilat Shqipëria është palë sikundër është Konventa e Bernës në nenin 2 e në vijim dhe Marrëveshja e TRIPS-it në nenin 10 e në vijim. Ato mund të ndahen në dy lloje: 1. *Programe (softëare) sistemi*, të cilat shërbejnë për funksionimin e pajisjes kompjuterike në vetvete, siç janë sistemet operative (\*\*\*, \*\*\*) etj); 2. *Programe (softëare) aplikacionesh*, të cilat shërbejnë për qëllime të ndryshme në varësi të programit p.sh (\*\*\*, \*\*\*) etj)-citohen nga pala paditese nennt e Konvetës së Bernës, neni 134 I ligjit 9380/2005; neni I 10 të Marrëveshjes së TRIPS-it sipas te cilit programet kompjuterike përfshihen në kuptimin e veprës letrare dhe mbrohen si të tilla nga Konventa e Bernës (neni 2).

Si një produkt i intelektual të njeriut i mbrojtur nga legjislacioni kombëtar dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare, programet kompjuterike nuk mund të përdoren nga subjekte të ndryshëm nga autori i tyre pa autorizimin përkatës. Ky autorizim në rastin e shoqërisë \*\*\* jepet nga liçenca , e cila përfaqëson marrëveshjen midis autorit dhe një subjekti tjetër me objekt kalimin e të drejtës së përdorimit të programit kompjuterik sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje.

Pala e paditur ka përdorur me qëllim përfitimi në vëndin ku zhvillohet aktiviteti tregtarë programin kompjuterik \*\*\* Profesional në pronësi të palës paditëse. Ky fakt u provua nga personi i tretë Drejtoria e të Drejtës së Autorit me Proçes Verbal monitorimi i datës 06.10.2014 në të cilin është pasqyruar gjendja e subjektit palës së paditur në momentin e inspektimit në zbatim të Urdhërit nr. \*\*\* datë \*\*\*. Gjatë kontrollit janë gjetur kompjuterat në përdorim të cilët ishin të palicensuar pra pa pullën përkatëse me anë të së cilës të provohej me kodet e pasqyruar që ishin me programe të licesuara. Të ndodhur në këto kushte inspektorët kanë vendosur edhe gjobën me nr. serial \*\*\* datë \*\*\* në vlerën \*\*\* lekë. Pra pasi vetë pala e paditur nuk ju ka dhënë asnjë dokument për të provuar

që kishte licencat për përdorimin e autorizuar të \*\*\*.

U provua nga pohimi gjyqësorë që pala e paditur nuk e ka ankimuar gjobën e vënë nga ish ZSHDA.

U provua që pala e paditur nuk mund të paraqiste asnjë provë më anë të së cilës të provonte që programet e instaluar në kompjuterat e tyre në pronësi të palës paditëse \*\*\* kanë qënë të licënuara. Nga ana e palës së paditur u paraqit një fature me TVSH me nr.Fature \*\*\* datë \*\*\*për blerjen e \*\*\* Kompjuterave dhe \*\*\* serverave por që nuk kishte asnjë license të blerë më këto kompjutera.

U provua se programet kompjuterike të përdoruara nga i padituri në ambientet e aktivitetit të tij tregtar sipas konstatimit të inspektorëve të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit nuk ishin të pajisura me liçencat përkatëse prandaj ato janë në shkelje të së drejtë së autorit. Inspektorët e Zyrës Shqiptare të Drejtës së Autorit gjatë inspektimit kanë konstatuar në ambjentin ku zhvillon aktivitetin Call Center pala e paditur kompjuterat PC të cilat përdorin programe kompjuterike në pronësi të Korporatës \*\*\* pa autorizimin përkatës, liçensat e tyre duke shkelur të drejtën e autorit që kjo shoqëri gëzon.

Ne një linjë me sa më sipër dhe përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", u provua përdorimi i paautorizuar me qëllim përfitimi i programit kompjuterike \*\*\* në pronësi të palës paditëse cili ka cënuar të drejtën e shfrytëzimit duke e pëligjur që ndër të tjera të kërkoj gjyqësisht shpërblimin e dëmit të shkaktuar

U provua se pala paditëse në datë 03.03.2014 ka blerë \*\*\* kompjutera dhe \*\*\* servera. Nga kontrolli i kryer gjatë inpektimit duke mos pasur detyrimin ligjore nuk është përcaktuar se sa kompjutera ishin pa pulle dhe sa kompjutera ishin me pull të grisur. Të ndodhur në këto rrethana për të qënë të sigurt në lidhje me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paautorizuar kemi kërkuar informacion në lidhje me numrin e të punësuarve pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ISHIPSHSH të cilët me shkresën e tyre me Nr.prot \*\*\* datë \*\*\* kanë konfirmuar \*\*\* të punësuar. Ndërkohë në lidhje me numrin e të punësuarve në vitin 2014 ky institucion ka konfirmuar 60 të punësuar në shkresën me nr.prot \*\*\* datë \*\*\* , dal si vetëdeklarim i subjektit pranë ISHIPSHSH. Të ndodhur në këto rrethana dhe duke marrë në konsideratë faktin e përshkrimit të kryer nga ana e inspektorëve të ZSHDA-s sot DDA-s sa kohë që gjendja e konstatuar ishte e ndarë në kompjutera pa pulla dhe me pulla të grisura të cilat do të mundësonin konfirmimin e licensimit on line nga inspektorët e ZSHDA-s dëmi i shkaktuar nga shkelja e të drejtës së autorit të shkaktuar shoqërisë \*\*\* nga pala paditëse është si më poshtë: \*\*\*70 kopje \* \*\*\* USD = \*\*\* USD

Pra dëmi i shkaktuar për shoqërinë \*\*\* është në masën \*\*\* Usd për shkeljen e konstatuar nga inspektorët e ZSHDA-s për shkeljen e kryer nga pala e paditur.Arsyeja për të cilën kemi përlllogaritur këtë numër PC është pasi duke ju referuar shkresës me nr. \*\*\* datë \*\*\* të Inspektoratit Shtetërorë i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Dega Rajonale Tiranë pala e paditur nga deklarimet vullnetare ka të siguruar \*\*\* punëmarrës. Ndërkohë që nga ana jonë është kërkuar vetëm ½ si numër \*\*\*.

Pala paditëse persa me lart ben referim dhe ne nenet 46 të Marrëveshjes së TRIPS-it;ne Kodin Civil nenet 608, 640 dhe dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar ( pra humbjen e pësuar përdorimi i paautorizuar i veprës së tjetrit, programeve kompjuterike, që njihet ndryshe si dëm emergjent ose humbje e shkaktuar nga fakti i paligjshëm, si dhe fitimi i munguar .

Pala paditëse kerkon pranimin e padise sipas objektit.

**Ne prapesimet e pales se paditur gjejme si qe** duke u referuar fakteve dhe rrethanave, rezulton se pala paditëse shprehet se në datë 06/10/2014, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka kryer kontroll në zyrat e palës së paditur ku ka konstatuar se kjo e fundit shfrytëzonte në ambientet e saj të punës, programe kompjuterike të pa pajisura me licensen përkatëse. Pas këtij verifikimi, autoriteti përkatës ka proceduar me gjobitjen e subjektit sipas nenit 131 pika 1 e ligjit "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" sipas gjobës Nr. \*\*\*, datë \*\*\*.

Me shkresën Nr. \*\*\* pala paditëse ka kerkuar nga pala e paditur arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me të drejtat pasurore që rjedhin nga e drejta e pronësisë mbi veprën, në këtë rast mbi

programet kompjuterike.

Shoqeria \*\*\*, është një shoqeri call center dhe si e tillë, mjetet kryesore për ushtrimin e funksionit të saj janë kompjuterat.

Në datën 09/01/2014 dhe 03/03/2014 shoqeria jonë ka blerë nga \*\*\* një sasi prej \*\*\* kompjutera (ekran dhe monitor) të përdorura me faturë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, dhe shoqeria \*\*\*, është e licensuar dhe ushtron aktivitetin e saj si kompani që merret me tregëtinë e pajisjeve elektronike. Kompjuterat u blenë të përdorura nga ana jonë, për arsye që kompania ti merrte ato më lirë nga çfare mund ti merrte të reja. Në një kompjuter të përdorur është mëse normë të këtë dëmtime të vogla për shkak të përdorimit ose më saktë të keqpërdorimit nga personat që e kanë pasur përpara se kompania \*\*\* ti blente dhe ti shiste përsëri tek ne. Përveç kësaj, kompania ka mbi 200 operator të punësuar dhe kompjuterat përdoren gjatë gjithë kohës nga operatorë të ndryshëm. Nuk mund të pretendohet se etiketa e grisur në një kompjuter të përdorur nënkupton se kompjuteri me këtë etiketë është i pa licensuar dhe që etiketa është grisur qëllimisht nga ana e kompanisë. Përsa i përket këtij pretendimi, pala paditëse nuk mund ta provojë këtë fakt.

Rezultoni se më datë 06/10/2014, pranë Shoqërisë \*\*\*, janë paraqitur inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Gjatë kontrollit të kryer kanë mbajtur procesverbalin e monitorimit Nr. 2 ku kanë konstatuar se në call center kishte në përdorim kompjuter me pullë \*\*\* dhe me sistem operativ të instaluar \*\*\* me nr. \*\*\* si dhe kompjutera pa pull (me pull të grisur) me sistem operativ \*\*\* me nr. \*\*\* të palicensuar.

Pas këtij konstatimi, grupi i kontrollit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka gjobitur Shoqërinë \*\*\*. për "Shfrytëzim, përdorim të programeve kompjuterike në abjentet e tij tregëtare të pa licensuar."

Më pas, me datë 16/04/2015 po ky grup inspektorësh të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit kanë përsëritur kontrollin në shoqërinë \*\*\* nga ku kanë konstatuar se: "Në call center subjekti kishte në përdorim të instaluar programe \*\*\*."

Referuar provave shkresore të përmendura më sipër, rezultoni se nga kontrolli i ushtruar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, nuk është evidentuar se sa është numri i kompjuterave që kanë programe të licensuara dhe sa është numri i kompjuterave që pretendohet se operonin me sisteme operative në pronësi të paditësit pa licensë dhe për çfarë periudhe, pasi në kontrollin e dytë të ushtruar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, pas 6 muajsh, ka rezultuar se pala e paditur nuk përdorte më sisteme operative në pronësi të paditësit.

Në kontrollin e datës 06/10/2014 të bërë nga Inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, bazuar në procesverbalin, rezultoni se Shoqëria \*\*\* sh.p.k. ka në përdorim të saj kompjuter me pullë OEM dhe pa pullë, (me pullë të grisur). Në këtë procesverbal nuk është përcaktuar numri i kompjuterave të gjetur në këtë call center. As në raportin e plotë mbi Inspektimin nuk përcaktohet numri i kompjuterave të gjetur. Për subjekte të tjera janë sekuestruar kompjutera apo masa të tjera të rrepta gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast me të paditurin. Në raportin e hollësishëm në lidhje me subjektin \*\*\* nuk ka asnjë lloj shpjegimi. Kundërshtojmë sa i takon provave që pretendon paditësi për procesverbalin e parë sepse nuk provohet fakti që inspektorët të kenë arritur në përfundimin se kompania përdorte programe \*\*\* sepse grupet e kontrollit bënë vetëm kontrollin fizik sic del edhe nga procesverbali, (me pullë ose pa pullë), pa parë realisht çfarë programesh përdorëshin në kompjuter. Pra shoqëria \*\*\* nuk përdor programe \*\*\* por programe free me të cilat zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm; nuk rezultoni se grupi i kontrollit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit të ketë kontrolluar funksionimin e këtyre programeve dhe të ketë treguar mënyrën se si ka arritur në përfundimin se disa programe kompjuterike të përdorura nga pala e paditur janë kopje të pa licensuara, por është mjaftuar në evidentimin në mënyrë visive të kompjuterave me pull apo pa pull. Pra, provat ku mbështet pretendimin pala paditëse nuk provojnë në mënyrë të pakontestueshme se pala e paditur të ketë përdorur për qëllime tregëtare programe kompjuterike fallco (kopje të programeve origjinale).

Sa i takon shpërblimit të dëmit, sipas shkresës me nr. \*\*\* prot. Datë 24/04/2016 të \*\*\* Albania rezultoni se cmimi i shitjes së programeve \*\*\* është \*\*\* usd.

Pala paditëse pretendon se janë gjetur në pronësi të të paditurit \*\*\* kompjutera të cilat ishin të palicensuara. Duke marrë parasysh provat dhe faktet e depozituara përpara gjykatës, pala paditëse nuk mund të arrijë që të provojë numrin e saktë të kompjuterave të palicensuara; në procesverbalin e mbajtur nga inspektorët e ZSHDA-së, nuk është caktuar as numri i kompjuterave që ishin të licensuara, as numri i kompjuterave të palicensuara ose me pull të grisur. Për sa më sipër, pala paditëse nuk mund të dijë numrin e saktë të kompjuterave të palicensuara dhe nuk mund ta provojë se numri i saktë i kompjuterave të palicensuara ishte 70 kompjutera dhe për pasojë si ka arritur paditësi që të llogarisi dëmin e shkaktuar në shifrën \*\*\* usd ose \*\*\* leke

Pala paditëse ben referim në nenet 8,11 dhe 12 të Kodit të Procedurës Civile ; Ligjin Nr. 9380, datë 28/04/2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile,

Perfundimisht kerkohet rrezimi i padise.

**Ne shpjegimet e personit të trete** pasi behet referimi konkret në akte ligjore dhe në

Ligjore (ligji 35/2016 ,urdhëri i Kryeministrit nr.179 date 28.12.2016) theksohet që ZSHDA është ristrukturuar në Drejtori brenda Ministrisë së Kulturës me emërtimin Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe të drejtave të lidhura me të. Referuar ligjit 9380/2005 e ZSHDA Inspektoret ushtronin të drejtat e tyre për monitorimin dhe inspektimin e tregut të të drejtave të autorit; në rastet kur konstatohej se kishte cenim të tyre inspektorët aplikonin masën administrative gjore. Në rastin në gjykim në vijim të urdherit të punës inspektorët kanë bërë kontroll pranë palës së paditur dhe kanë konstatuar përdorim të programeve kompjuterike pa licencë – pasqyruar në procesverbalin përkatës dhe është vendosur gjore; është ushtruar serish kontroll pas 6 muajsh dhe është konstatuar se kishte në përdorim programe free. Ligji 9380/2005 nuk parashikon ndonjë shifer minimale apo maksimale cenimesh në mënyrë që të kualifikohet shkëlqja e të drejtës së autorit që të përliqej masën administrative. Drejtoria shprehet ekskluzivisht mbi konstatimin e kryer nga inspektorët e ZSHDA; pra këto janë kontrole të ushtruara në \*\*\* nga ana e inspektoreve të ZSHDA.

**Gjykata** pasi u njoh me pretendimet dhe kerkimet e palës paditëse, me prapësimet e palës së paditur, me shpjegimet e personit të trete, bazuar në provat e paraqitura dhe në ligjin në fuqi analizon:

pala paditëse, shoqëria \*\*\* bazuar në dokumentacionin e paraqitur në gjykim, është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Uashingtonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e ushtron veprimtarinë e saj prej datës \*\*\*, si një shoqëri e njohur globalisht në fushën e krijimit dhe tregtimit të pajisjeve dhe programeve kompjuterike.

Pala paditëse në padinë e saj në pretendimet e parashtruara gjykates, paraqitet si mbajtëse e së drejtës/pronare e disa programeve kompjuterike mes të cilave dhe \*\*\* duke pretenduar në këtë kontekst dhe të drejtat e autorit në përputhje me legjislacionin në fuqi/në fushën e të drejtës kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Në këtë gjykim fakti i mesipër/autoresia e palës paditëse dhe mbrojtja e saj/nuk është kontestuar nga pala e paditur.

Në ligjin 9380/2005, i ndryshuar-si ligji në fuqi i kohës referuar çështjes objekt gjykimi- në nenin 134 të tij gjejmë të përcaktuar që:

*‘Mbrojtja e të drejtës së autorëve të huaj dhe e të drejtave të lidhura me ta*

*1. Veprat e autorëve të huaj mbrohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve*

*ndërkombëtare, në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë...’*

dhe për sa më lart –sikurse ka referuar shprehimisht dhe pala paditëse kemi Konventën e Bernës’Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike’ e vitit 1971/ndryshuar në vitin 1979 /adheruar RSh me dekretin e Presidentit të Republikës me nr.487/09.03.1993 dhe në të cilën kemi :

Neni 2: *“1.Shprehja "vepra letrare dhe artistike" përfshin çdo prodhim në fushën letrare, shkencore*

dhe artistike, të çfarëdo mënyre apo forme të shprehjes së saj, të tilla si libra, pamflete dhe shkrimet e tjera; leksione, adresa, predikime dhe vepra të tjera të së njëjtës natyrë; vepra dramatike ose dramaticomusical; veprat koreografike dhe argëtimet në shfaqje memec; kompozimet muzikore me ose pa fjalë; punët kinematografike vepra të cilat janë asimiluar e shprehur nga një proces i ngjashëm me kinematografinë; veprat e vizatime, pikturë, arkitekturë, skulpturë, gdhendje dhe litografi; veprat fotografike të cilat janë asimiluar vepra të shprehura nga një proces i ngjashëm me fotografinë; veprat e artit të aplikuar; ilustrime, harta, plane, skica dhe vepra tre-dimensionale të afërm të gjeografisë, të topografisë, arkitekturës ose shkencë. 2...”

Neni 5: “1. Autorët persa i perket veprave per te cilat ata mbrohen nga kjo Konvente, ne vendet e Bashkimit,pervecse ne vendin e origjines,gëzojnë te drejtat qe do ti japin shtetasve,tani e tutje,ligjet e tyre perkatese.

2.Gëzimi dhe ushtrimi i këtyre të drejtave nuk do te kushtezohet nga asnje formalitet;Gëzimi dhe ushtrimi i tillë do të jetë i pavarur nga ekzistenca e mbrojtjes në vendin e origjinës së punës.

Si pasojë, përveç dispozitave të kësaj Konvente, shtrirja e mbrojtjes aq sa mbeshtetja e dhene autorit per te mbrojtur të drejtat e tij, do të rregullohen ekskluzivisht nga ligjet e vendit ku është kërkuar mbrojtja.

3.Mbrojtja në vendin e origjinës rregullohet nga ligji i brendshëm.Megjithatë, kur autori nuk është shtetas i vendit të origjinës se vepres për të cilën ai është nen mbrojtjen e kësaj Konvente, do të gëzojnë në atë vend të njëjtat të drejta si autorët vendas.

4.Vendi i origjinës do të konsiderohet.....”

si dhe Marrëveshjen e TRIPS-it.

Referuar ligjit ne fuqi ne RSh /ligji 9380/2005, i ndryshuar (ndryshimet e fundit me ligjin 78/2013-para fakteve te parashtruara ne kete gjykim mbi shkelje te konstatuara qe i perkasin vitit 2014 )ne te gjejme te percaktuar shprehimisht:

“Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e të drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të lidhura me të.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjektit pjesëmarrës në veprimtaritë krijuese, prodhuese, tregtare ose në çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike apo shkencore.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari krijuese, tregtare, prodhuese apo çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.’,

dhe ne nenin 4 te tij,lidhur me perkufizimet qe jep ky nen kemi:

42. "Software i kompjuterit" nënkupton një përshkrim të hollësishëm të programit të kompjuterit, që përcakton udhëzimet për përdorimin e programit dhe të materialeve të tjera mbështetëse, në formën e udhëzimeve, të krijuara për të ndihmuar të kuptuarit ose zbatimin e programit.’

Ne lidhje me ceshtjen ne gjykim pala paditese,sikurse thame me lart,paraqitet ne cilesine e mbajteses së te drejtës/pronare e disa programeve kompjuterike mes te cilave dhe \*\*\*,programe qe nga ana e tyre perfshihen ne ligjin e sipercituar –pra perbejne ‘veper’,gje e cila gjen rregullim te shprehur ne ligj-9380/2005,I ndryshuar:

‘Neni 75

Të drejtat mbi një vepër, program kompjuteri

Ushtrimi i të drejtave të shfrytëzimit ekonomik mbi një vepër, program kompjuteri, bazohet në dispozitat e mëposhtme dhe, nëse nuk është e përcaktuar shprehimisht, në dispozitat e tjera, të përgjithshme ose të posaçme, të këtij ligji.

Neni 76

Mbrojtja e programit kompjuterik

1. Një program kompjuterik mbrohet vetëm kur është origjinal, që do të thotë se është rezultat i aftësisë krijuese intelektuale të autorit të programit.

2. Mbrojtja e parashikuar në këtë ligj zbatohet për çdo formë të shprehjes së një programi kompjuterik, për të gjitha versionet pasardhëse ose për programet që rrjedhin prej tij.

3. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji, nëse një program kompjuterik është i përfshirë në një diplomë a model përdorimi, ai përfiton mbrojtje nga dispozitat ligjore për mbrojtjen e pronësisë industriale.

Neni 77

*Mbrojtja e dokumentacionit teknik dhe e udhëzuesit të përdorimit*

Dokumentacioni teknik dhe udhëzuesit e përdorimit të një programi kompjuterik gëzojnë të njëjtën mbrojtje si dhe vetë programi kompjuterik, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 78

*Përjashtimi nga mbrojtja*

Nuk mbrohen nga dispozitat e këtij ligji idetë dhe parimet që janë në themel të çfarëdo lloj elementi të një programi kompjuterik, përfshi këtu edhe ato që janë në themel të ndërfaqeve të tij.

Neni 79

*Autori i programit kompjuterik*

1. Autori i programit kompjuterik është individ ose grupi i individëve, të paraqitur në çdo lloj mënyre shoqërizimi, të cilët kanë realizuar veprën me kontributin dhe aftësitë e tyre krijuese. Nëse programi kompjuterik është një vepër e realizuar në bashkëpunim, për të zbatohen dispozitat e nenit 7 të këtij ligji, nëse nuk është rënë dakord ndryshe.

2. Personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni janë titullarë të të gjitha të drejtave mbi veprën, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.....'

(pala paditese ne kete pike ka bere referim dhe ne marreveshjen e TRIPS-it duke u shprehur qe sipas nenit 10 te saj : Neni 10 : "1. Programet kompjuterike, qoftë në kodin burim ose objekt, do të mbrohen si vepra letrare sipas Konventës së Bernës (1971). 2. Baza e të dhënave apo... „programet kompjuterike përfshihen në kuptimin e veprës letrare dhe mbrohen si të tilla nga Konventa e Bernës (neni 2). Në paragrafin I të këtij neni programet kompjuterike mbrohen në të 2 elementët përbërës të tyre : kodi burim- i cili përfaqëson tërësinë e udhëzimeve kompjuterike shkruar duke përdorur një gjuhë kompjuterike të kuptueshme nga njeriu; dhe kodi objekt – i cili përfaqëson produktin pas procesimit të kodit burim nga përpiluesi. Kodi burim është versioni i programit siç hartohet nga programuesi informaticien. Përpiluesi është një mekanizëm i specializuar që konverton kodin burimor, në kod objekt. Ky përkufizim është në linjë me atë të përcaktuar në ligjin nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të". Si një produkt i intelektual të njeriut i mbrojtur nga legjislacioni kombëtar dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare, programet kompjuterike nuk mund të përdoren nga subjekte të ndryshëm nga autori i tyre pa autorizimin përkatës. Ky autorizim në rastin e shoqërisë \*\*\* jepet nga liçenca , e cila përfaqëson marrëveshjen midis autorit dhe një subjekti tjetër me objekt kalimin e të drejtës së përdorimit të programit kompjuterik sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje)

Te ndodhur para nje vepre/program kompjuterik/te trajtuar si te tille nga ligji I siperpermendur,para autorit te vepres,mbrojtjes ligjore qe ai gezon,bejme referim dhe ne nenin 12 dhe 13 te ligjit 9380/2005,I ndryshuar, I cili i referohet te drejtes pasurore ne kuader te permbajtjes se te drejtes se autorit dhe parashikon si te tille :

'Neni 12

*E drejta pasurore*

1. Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës së vet në çdo formë dhe mënyrë.

.....

Neni 13

*E drejta ekskluzive e shfrytëzimit të veprës*

1. Autori gëzon të drejtën ekskluzive për ta shfrytëzuar veprën e vet në formë materiale dhe jomateriale.

2. Autori gëzon të drejtën ekskluzive, duke pasur parasysh veprën e vet, në tërësi ose pjesërisht, për të autorizuar:

a) riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkohshëm ose të përhershëm me çfarëdo lloj mjete apo forme;.....'



dhe perkundrejt se ciles gezon(autori) te drejten e shperblimit sipas kushteve te parashikuara ne nenin 12 / 2 te ligjit 9380/2005, I ndryshuar-citojme:

'2. Autori i një veprë letrare, artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për çdo rast dhe për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës, të lejuar apo jo nga vetë ai, edhe nese heq dore nga kjo e drejte'.

E drejta e shperblimit(shperblim dmi) eshte nje e drejte e parashikuar dhe ne nenet 118 e vijues te ligjit 9380/2005, I ndryshuar sipas te cilit:

*Neni 118*

Dispozita për të drejtën e shfrytëzimit

1. Çdo person, i cili pretendon se një veprim i caktuar i cenon të drejtën e shfrytëzimit, që e gëzon sipas dispozitave të këtij ligji, ose që përpiqet të ndalojë vazhdimin a përsëritjen e veprimit cenes, të kryer më parë, ka të drejtë të fillojë procedurat ligjore nëpërmjet organeve përkatëse, për t'u siguruar që e drejta e tij të njihet dhe veprimi cenes të ndalohet.

2. Procedurat mbështeten në dispozitat e këtij seksioni dhe në dispozitat e Ko dit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

.....

*Neni 120*

*E drejta për procedim ligjor*

Çdo person, të cilit i cenohet ushtrimi i të drejtave të tij për shfrytëzimin e veprës, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të nisë procedim ligjor në organet gjyqësore kompetente, për të kërkuar shkatërrimin ose asnjësimin e materialeve dhe/ose të pajisjeve dhe shpërblim për dëmin e shkaktuar.'

Ne ceshtjen object gjykimi pala paditese ka parashtruar perkundrejt pales se paditur:

**A)- Njohjen e shkeljes së të drejtave të autorit nëpërmjet përdorimit të paautorizuar të programeve kompjuterike, pa liçencat përkatëse nga pala e paditur.**

Sipas kesaj pale programet kompjuterike nuk mund te perdoren nga subjekte te ndryshem nga autori I tyre pa autorizimin perkates, I cili ne rastin e shoqerise \*\*\* jepet nga licenca,nderkohe qe pala e paditur ka perdorur me qellim perfitimi ne vendin ku zhvillon aktivitetin tregetar programin kompjuterik \*\*\* ne pronesi te saj te palicencuar /te paautorizuar.

Ne lidhje me sa me lart gjykata analizon:

ne provat e paraqitura ne gjykim kemi nje urdher me numer \*\*\* date \*\*\* te leshuar nga Drejtori i ZSHDA ( e krijuar ne perputhje me ligjin 9380/2005) sipas te cilit do te kryhej nje kontroll ndaj subjekteve perdorues te veprave qe perbejne object te ligjit 9380/2005,I ndryshuar per periudhen 06.10.2014/ne kete urdher eshte percaktuar dhe e tregtare te perdoruesve dhe vendosja e gjobes ne rast konstatimit te cenimit te LDA –se. Bazuar ne Urdherin e cituar me lart eshte kryer kontroll ne ambientet e pales se paditur shoqerise \*\*\* shpk dhe ku inspektoret ne daten 06.10 .2014 jane paraqitur ne seline e kesaj shoqerie me aktivitet Call Center,ne prani te administratorit te saj \*\*\* dhe eshte konstatuar se:

'...gjate veprimtarise call center kishte ne perdorim kompjutera me pulle OEM \*\*\* dhe me sistem operimi të instaluar \*\*\* me nr. \*\*\* si dhe kompjutera pa pule (me pull të grisur) me sistem operimi \*\*\* me nr. \*\*\* të palicensuar.'

Sa me lart gjen pasqyrim ne Procesverbal Monitorimi nr. \*\*\* date \*\*\*, I cili eshte nenshkuar nga inspektoret dhe nga perfaqesuesi I shoqerise pale e paditur.

Ne vijim inspektoret kane leshuar dhe fleten e gjobes Nr. \*\*\*, datë \*\*\* ne te cilen kane pasqyruar qe subjekti gjate ushtrimit te veprimtarise se tij ka konsumuar shkelje administrative te parashikuara nga neni 130/1/c te ligjit 9380/2005,I ndryshuar dhe duke pershkruar konkretisht shkeljen:

*'Shfrytëzim ,perdorim I programeve kompjuterike ne ambientin e tij tregetar te palicensuar'.*

Gjoha e vendour eshte ne perputhje me nenin 131/ligji 9380/2005 dhe ne masen \*\*\* leke duke e pasqyruar ne menyre te shprehur ne te dhe te drejten e ankimit sipas ligjit-fleta e gjobes gjithashtu eshte nenshkruar dhe nga perfaqesuesi I pales se paditur.

(nenet "130

2. *Kundërvajtjet administrative, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dënohen me gjobë, si më poshtë:*

a) *për rastet e parashikuara në shkronjën "a", "c", "ç" dhe "d", me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë;*

*Neni 131*

1. *Inspektorati që mbulon fushën e të drejtave të autorit*

*Inspektorati që mbulon fushën e të drejtave të autorit përcakto*

*het me vendimin të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.*

2. *Inspektorët vendosin ndaj kundërvajtësit dënimin kryesor*

*me gjobë kur gjatë inspektimit konstatojnë shkeljet, në juridiksionin e të cilëve është kryer kundërvajtja administrative.*

*".*

*"Neni 132*

*Ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative*

1. *Kundërvendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.*

2. *Kundër vendimit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit mund të bëhet ankim sipas dispozitave në fuqi.*

3. *Ekzekutimi i gjobës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.*

*".)*

Gjate ketij gjykimi sipas pohimeve te pales se paditur kjo gjobe nuk eshte ankimuar as ne rruge administrative dhe as gjyqesore,sipas percaktimeve te ligjit/nderkohe kjo perkon dhe me faktin qe nuk u paraqit ne gjykim asnje prove qe te vertetonte sa me lart(ankim)dhe aq me teper anullimin e gjobes se vendosur.

Pra pala e paditur dhe pse kishte dijeni rregullisht mbi sa u konstatua nga inspektorët e ZSHDA nuk e ka kundërshtuar gjoben e vene dhe per rrjedhoje dhe as faktin e konstatuar nga inspektorët:

-gjate veprimtarise pala e paditur kishte ne perdorim kompjutera pa pulle(me pulle te grisur) me sistem operimi te instaluar \*\*\* me nr. \*\*\* të palicensuar;

-gjate ushtrimit te veprimtarise se subjektit ka konsumuar shkelje administrative te parashikuara nga neni 130/1/c I ligjit 9380/2005, I ndryshuar (neni 130/1/c: *'Kundërvajtjet administrative 1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative veprimet ose mosveprimet e çdo personi fizik ose juridik, për qëllim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë fitimi, si më poshtë: c) shkelja e dispozitave të neneve 75 e në vijim për programet kompjuterike'*)

Referuar raportit te plote nr.93/1 date 14.10.2014 mbi inspektimin e kryer ne permbajtje te tij eshte pasqyruar qe ne momentin e inspektimit subjekteve I eshte kerkuar *venia ne dispozicion per kategorine e subjekteve Call Center e fatures se blerjes se licencave te programeve qe kane ne perdorim dhe konstatimi ne vend I menyres se perdorimit dhe megjithe kete perseri nga pala e paditur nuk rezulton qe ti jene vene ne dispozicion sa me lart edhe pse iu eshte dhene nje mundesi e tille.*

Sa pasqyrohet ne kete raport hedh poshte dhe prapesimin e pales se paditur qe nuk rezulton qe grupi I kontrollit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit të ketë kontrolluar funksionimin e këtyre programeve dhe të ketë treguar mënyrën se si ka arritur në përfundimin se disa programe kompjuterike të përdorura nga pala e paditur janë kopje të pa licensuara, por është mjaftuar në evidentimin në mënyrë visive të kompjuterave me pulle apo pa pulle.Dhe kjo persa eshte kerkuar konstatimi ne vend I menyres se perdorimit si dhe eshte

konstatuar perdorimi i sistemit te operimit te instaluar \*\*\* me numer konkret.

Ndodhur para konstatimit nga inspektoret conform percaktimeve te ligjit te kohes ne fuqi si dhe faktit qe vete pala e paditur nuk ka ankimuar,kundershtuar gjoben/dhe se bashku me te faktin e kryerjes se shkeljes nga ana e tij,provohet/ne mungese provash te kunderta ne kete gjykim/qe pala e paditur ka perdorur –shfrytezuar programe kompjuterik te palicencuar,nderkohe qe shfrytezimi I ketij programi(vepre)eshte e drejte ekskluzive e autorit te saj qe perfshin te drejten per te bere apo per te autorizuar per te vepruar sipas nenit 81 te ligjit 9380/2005(kemi perjashtimet e nenit 82 te cilat kane te bejne me perdoruesit e ligjshem dhe ato te nenit 83).

Ne rastin ne gjykim pala e paditur ka perdorur programin \*\*\* te palicencuar/pra eshte nje person- subjekt I palicensuar per perdorim,nje perdorues jo i ligjshem,/dhe as I autorizuar nga pala paditese per te shfrytezuar kete veper-program kompjuterik.

Nga ana tjeter pergjate ketij gjykimi pala e paditur (dhe nese do te pranonim qe mosankimi I gjobes ka qene nje zgjedhje e saj ndoshta dhe per shkak te vleres jo te larte te gjobes)kishte te gjitha mundesite dhe mjetet ligjore qe te paraqiste ne gjykim prova per te provuar qe nuk ka qene ne kushtet e nje perdorimi/shfrytezimi jo te ligjshem te programit kompjuterik por ka qene I pajisur me licencen perkatese per programin kompjuterik object shqyrtimi.Pala e paditur nuk paraqiti asnje prove te tille.

Fakti qe:

-pala e paditur I ka blere kompjuterat/\*\*\* cope set dhe \*\*\* server nga nje subjekt tjeter,te perdorur sipas fatures nr. \*\*\* date \*\*\* (e pashoqeruar me faturen e blerjes se licenses perkatese),

-ne kontrollin e ushtruar prane pales se paditur ne vitin 2015 nga ZSHDA nuk jane gjetur ne perdorim programe pa license por programe kompjuteri free -sipas procesverbal monitorimit date 16.04.2015,

nuk ka te beje me rretthanat e vertetuara ne kontrollin e ushtruar ne daten 06.10.2014 ku eshte konstatuar shkelja e kryer dhe per te cilen ne kete gjykim nuk u paraqiten prova qe te vertetonin te kunderten.

Persa me lart nga provat e paraqitura ne kete gjykim vertetohet plotesisht shkelja e kryer nga pala e paditur e te drejtes se autorit te vepres/program kompjuterash,shoqerise \*\*\* per shkak te shfrytezimit te vepres nga pala e paditur ne ambientin e saj tregetar dhe per qellime fitimi (nisur nga veprimtaria qe ajo zhvillon) te palicensuar, duke u perligjur plotesisht kerkimi I pales paditese ne lidhje me njohjen e shkeljes së të drejtave të autorit nëpërmjet përdorimit të paautorizuar të programeve kompjuterike, pa liçencat përkatëse nga pala e paditur.

**B) Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i paautorizuar i programeve kompjuterike pa liçencat përkatëse shkaktuar në vlerën \*\*\* Usd e konvertuar në lekë \*\*\* lek**

Ne lidhje me sa me lart pala paditese ka bere referim jo vetem ne ligjin 9380/2005,I ndryshuar I cili njeh te drejten e shperblimit te demit ne nenin 12,118 e vijues te tij por dhe ne nenin 46 te Marreveshjes se Trip-sit dhe ne KC nenet 608 e vijues,640 etj(ne kuader kjo te nje demi jashtekontraktor)-citojme dhe nenet:

**Neni 46, Dëmet:** “1. Autoritetet gjyqësore do të kenë autoritetin të urdhërojë shkelësin e së drejtës për shpërblimin e dëmit të mbajtësit të së drejtës, mjaftueshëm për të kompensuar dëmin e pësuar për shkak të shkeljes të pronësisë intelektuale të atij personi, nga shkelësit, të cilët kishin dijeni, apo kishin mundësi të arsyeshme për të pasur dijeni,për angazhimin në aktivitetin çënues

2. Autoritetet gjyqësore do të kenë autoritetin për të urdhëruar shkelësin e së drejtës të paguajë shpenzimet e mbajtësit të së drejtës, të cilat mund të përfshijnë tarifën e shërbimit të avokatisë. Në rastet e përshtatshme, Anëtarët mund të autorizojnë autoritetet gjyqësore të urdhërojnë kthimin e fitimeve dhe /ose të pagesave të dëmit të paracaktuar edhe pse kundravajtësi nuk ka vepruar me vetëdije apo me mundësi të arsyeshme për të pasur dijeni, për angazhimin në aktivitetin çënues.,,

**Neni 608“ Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit ,,**

,Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

**Neni 640** ,Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Njohja e shkeljes se te drejtes se autorit nga pala e paditur perligj ne thelb kerkim per shperblim demi ne mbeshtetje te akteve te sipercituara duke iu njohur dhe e drejta e procedimit ligjor ne organet gjyqesore.

Ne lidhje me kete shperblim demi pala paditese me shkresen e saj te dates 26.11.2015 drejtuar pales se paditur ka kerkuar vleren prej \*\*\* Usd.

Ne mungese te nje marreveshje mes paleve pala paditese I eshte drejtuar gjykates se rrethit gjyqesor Tirane me padi(ku parashtron pretendimet,faktet dhe provat e saj)dhe duke kerkuar fillimisht(referuar permbajtjes se padise)vleren e shperblimit te demit prej \*\*\* Usd dhe ne vijim,gjate gjykimit, ne masen \*\*\* Usd e konvertuar ne lekë \*\*\* leke.

Referuar rregullimit ligjor te trajtuar me lart,ne ligjin e posacem 9380/2005, I ndryshuar, nuk ka nje rregullim specific ne lidhje me kriteret ligjore dhe menyren mbi te cilat te mundesohet kjo perllogaritje /vete pala paditese ben referim sikurse thame me lart ne nenet 608 e vijues dhe 640 te KC.

Sipas pales paditese(*parashtrimeve te saj*)demi ne masen \*\*\* Usd konsiston/perbehet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar(humbja e pësuar përdorimi i paautorizuar i veprës së tjetrit,programeve kompjuterike,që njihet ndryshe si dëm emergjent ose humbje e shkaktuar nga fakti i paligjshëm,si dhe fitimi i munguar)dhe me konkretisht eshte perllogaritur mbi keto kriteret:

-numer kompjuterash te palicencuar(referuar si te tille 70 cope),  
dhe

-vlere progami kompjuterik(vlere e produktit)-  
si dhe

-menyre perllogaritje:Windows 7 Proffesional 70 kopje \* \*\*\* USD = \*\*\* USD,  
ku argumenton:

‘...aresyeja për të cilën kemi përllogaritur këtë numër PC është pasi duke ju referuar shkresës me nr. \*\*\* datë 17.05.2016 të Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Dega Rajonale Tiranë pala e paditur nga deklarimet vullnetare *ka të siguruar \*\*\* punëmarrës*. Ndërkohë që nga ana jonë është kërkuar *vetëm ½ si numër \*\*\*.....*’, dhe

-vlera prej \*\*\* Usd,si vlere e konfirmuar nga dega e \*\*\* per programin kompjuterik \*\*\* (sot \*\*\*).

Pala paditese ne kete gjykim pretendon nje dem te shkaktuar saj prej \*\*\* Usd nga shkelje e te drejtes se autorit dhe ne pasoje te drejten e shperblimit te demit te shkaktuar.

Ne keto kushte dhe ne respektim te nenit 12 te KPrC:

“*Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj*”,

pala paditese eshte e detyruar qe te paraqese provat mbi demin e shkaktuar saj ne vleren prej \*\*\* USD.

Pala paditese ka paraqitur me cilesine e proves:

-shkresen nr. \*\*\* datë 17.05.2016 të Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Dega Rajonale Tiranë(*bashkangjitur se ciles formular deklarimi I dates 15.04.2016 dhe lista e punonjesve te pales se paditur*) sipas te ciles pala e paditur nga deklarimet online ka të siguruar \*\*\* punëmarrës;nderkohe kjo shkrese permban te dhenat

per vitin 2016- ndersa per vitin 2014 kohe ne te cilen eshte konstatuar shkelja kemi nje numer punonjesish ne daten 04.03.2014 prej 60 punemarres –sipas shkreses nr.260/1 prot date 22.05.2016 te ISHPSHSh,

-shkresen nr. \*\*\* prot date 26.04.2016 te shoqerise \*\*\* sipas te ciles behet referim ne vlerat aktuale per produktet software-citojme “*ju informoj se vlera aktuale per produktet software eshte si me poshte: \*\*\*...\*\*\* USd*”;

-referohet dhe fatura tatimore e blerjes paraqitur nga pala e paditur per numrin e kompjuterave te blere ne daten 03.03.2014 prej \*\*\* cope.

Gjykata duke iu referuar kriterëve dhe menyres se perlllogaritjes te perdorur nga pala paditese per percaktimin e vleres se demit te shkaktuar saj, menyres mbi te cilen kjo pale ka percaktuar numrin e kompjuterave ne perdorim te palicencuar(*referon ne numrin e punemarresve \*\*\* per te nxjerre numrin e kompjuterave me program te palicencuar 70 cope*), vleren e produktit dhe provave te paraqitura, cmon se kjo nuk eshte e bazuar ne prova ne kushtet kur :

a) lidhur me numrin e kompjuterave te palicencuar:

-ne procesverbalin e dates 06.10.2014 te inspektoreve te ZSHDA nuk është percaktuar numri I kompjuterave të gjetur ne perdorim në call center *si ne teresine tij /pra ne perdorim efektiv dhe as e atyre te palicencuar*; as në raportin e plote mbi Inspektimin nuk percaktohet numri I kompjuterave të gjetur-ne te në lidhje me subjektin “\*\*\*” sh.p.k nuk ka asnjë lloj shpjegimi;

-pala paditese nuk paraqiti asnje prove konkrete mbi numrin e kompjuterave te gjetur ne perdorim pa pulle /me program te palicencuar;

-referimi ne numrin e punemarresve te vitit 2016 I takon nje peridhe kohore shume me te ndryshme nga ajo e kohes kur eshte konstatuar shkelja (ne tetor te vitit 2014);

-percaktimi i numrit te kompjuterave ne masen ½ referuar numrit te punemarresve ne vitin 2016 nuk eshte gje tjeter vec nje perlllogaritje apriori dhe pa asnje kriter ligjor;

-numri I kompjuterave te blere ne daten 03.03.2014 (\*\*\* cope )/sipas fatures tatimore te shitjes( pa licence bashkangjitur)/ nuk verteton apriori se te gjithë keta kompjutera *se pari* jane futur ne perdorim apo te kene qene ne eficence deri ne daten 06.10.2014 dhe *se dyti* te kete qene te gjithë me sistem operimi te instaluar \*\*\* te pa licencuar(ne mungese te fatures se blerjes se licences)dhe apriori ne pasoje dhe ½ e tyre(70 cope)/kjo del dhe nga permbajtja e procesverbalit te inspektoreve te ZSHDA te cilet kane konstatuar egzistencen dhe te kompjuterave me program te rregullt,te licencuar/me pulle OEM;

per me teper vlera gjebes se vene ne referim te ligjit eshte ne kufijte minimale te tij si dhe e pashoqeruar me denime plotesuese fakt qe do te perkonte me nje shkelje jo te rende

b)lidhur me vleren e produktit:

vlera \*\*\* Usd I referohet vlerave per produktin ne kohen e leshimit te shkreses nga \*\*\* Albania ne vitin 2016 –citojme:“*vlera aktuale e produktit*”(pra vete subjekti shprehet per nje vlere aktuale te produktit/qe do te thote e vitit 2016 ,nderkohe qe nuk pasqyron faktin qe kjo vlere mbetet e pandryshuar ne kohe apo eshte e njejta dhe per vitin 2014) gje e cila nuk verteton vleren e produktit software( programit kompjuterit \*\*\* )ne nje kohe shume me te hershme ne vitin 2014-vit per te cilin nuk kemi asnje te dhene.

Per gjithë sa me lart vlera e demit te pretenduar nga pala paditese ne masen \*\*\*Usd (*e konvertuar në lekë \*\*\* leke*)perkundrejt se ciles kerkon shprerblimin nga pala e paditur ne kete mase eshte I pambeshtetur ne prova.

Pala paditese nuk arriti te provonte ne kete gjykim vleren e demit te shkaktuar saj prej \*\*\* Usd perkundrej te cilit ajo te perfitoje shperblimin perkates.

Nuk u porvuan as vlera tetjera te demit sipas percaktimeve ne nenin 640 te KC.

Pra dhe pse e drejta per shperblim demi eshte nje e drejte ligjore,kerkimi per shperblim duhet te rrezohet pasi nuk provohet vlere e demit/vlera e kerkuar eshte nje vlere jo reale,e pambeshtetur ne prova.

Ne lidhje me shpenzimet gjyqesore gjykata nisur nga lloji I padise se ngritur,nga konkluzionet e arritura nga gjykata mbi shkelje te se drejtes se autorit duke u njohur kjo

shkelje(kerkimi ne piken e pare te objektit te padise)dhe bazuar ne nenet 106 te KPrC cmon qe shpenzimet gjyqesore ti ngarkohen pales se paditur ne masen e pjeses se padise te pranuar nga gjykata,dhe me konkretisht si me poshte:

- Taksa gjyqesore ne masen \*\*\* leke (tarifa baze)
- Shpenzime avokatore te pales paditese ne masen \*\*\* Usd/ose \*\*\* leke
- Fletethirrje gjyqesore 25 cope ne vleren \*\*\* leke secila.

Perfundimisht

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 126 dhe 306 të Kodit Pr.Civile

## VENDOSI

-Pranimin e pjesshem te kerkesepadise.

*Njohjen e shkeljes së të drejtave të autorit nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike pa liçencat përkatëse nga pala e paditur.*

-Rrezimin e padise per pjesen tjeter.

-Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen pales se paditur ne masen e pjeses se padise te pranuar

nga gjykata,si me poshte :

- Taksa gjyqesore ne masen \*\*\*leke
- Shpenzime avokatore te pales paditese ne masen \*\*\* Usd/ose \*\*\*leke
- Fletethirrje gjyqesore 25 cope ne vleren \*\*\* leke secila.

-Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve,afat ky qe fillon nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

**-U shpall ne Tirane sot me dt.18.09.2017.**

**Sekretare**

**Arta Brajta**

**Gjyq**

**Enkela Baj**

### **Shpenzime gjyqesore:**

-Takse padie 1% -vlere e paguar nga pala paditese ne masen \*\*\*leke(pulla)+ \*\*\*leke (mandate bankar I BKT)

-Shpenzime avokatore te pales paditese ne masen \*\*\* Usd/ose \*\*\*leke sipas fatues tatimore nr.44 date 05.04.2017

-Fletethirrje gjyqesore 25 cope ne vleren \*\*\* leke secila te paguhen ne llogari te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane

